



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 64/2012
Prishtinë, më 16.05.2012, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha – Shala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Visar Ymeri, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Berat Buzhala dhe Ramiz Kelmendi.

Pjesëmarrësi i ftuar: Ahmet Tmava, kryesues i Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Pjesëmarrëse te tjerë: Ibush Jonuzi, Selvete Grajçevci –Pllana, Nurdin Bislimi dhe Ramiz Krasniqi –KPM; Burim Ejupi dhe Dita Dobranja - INDEP; Florije Mehemeti -KDI dhe Flamur Hyseni (ekspert ligjor-NDI).

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi, Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 08.05.2012;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2011;
4. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratuan pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 08.05.2012

Kryetari – Propozoi që të shtyhet miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 08.05.2012 për mbledhjen e radhës, për arsye se ende nuk është përkthyer në gjuhën serbe.

Komisioni përkrahu propozimin e kryetarit.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2011

Kryetari – Theksoi se, ashtu siç është paraparë, në këtë pikë të rendit të ditës do të shqyrtohet Raporti vjetor i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2011. Ne kemi ftuar përfaqësuesin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale- KPMM-së, z. Ahmet Tmava, i cili do të paraqesë një ekspozë të shkurtër për këtë Raport në Komision. Ai në vijim tha se, në kuadër të Raportit të KPMM-së e kemi dhe raportin vjetor të punës së Inspektoratit të Minierave për vitin 2011, po ashtu dhe nga shoqëria civile INDEP-i, kemi opinion dhe sugjerimet që kanë të bëjnë me këtë raport dhe pastaj do të hapim debat në lidhje me këtë çështje.

Ahmet Tmava (kryesues i Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale)

- I njoftoi deputetët për hapat e deritashëm që ka marrë KPMM-ja për përmbushjen e detyrimeve të dala nga Ligji për miniera dhe minerale, për të cilat tha se ato janë arritur në masën më të madhe dhe është duke u punuar në përmbushjen e tyre në tërësi. Z. Ahmet Tmava, në mënyrë kronologjike paraqiti hapat që ka marrë KPMM-ja, duke filluar nga puna e deritashme dhe sfidat që e përcjellin KPMM-në. Z. Tmava tha se në funksion të zbatimit të Ligjit për miniera dhe minerale, KPMM-ja në fokus të angazhimeve të veta ka mënjanimin e operatorëve ilegalë të eksploatimit të zhavorrit. Lidhur me këtë, ai njoftoi se KPMM-ja ka konfiskuar gjashtë (6) kamionë dhe një (1) ekskavator të operuesve ilegalë, ndërkaq, me shoqatën "Zhavorri" kanë bashkëpunim të ngushtë në luftimin e kësaj dukurie. Ai në vijim njoftoi për procedurat e licencimit të operatorëve, numrin e gjobave të shqiptuara, të hyrat e realizuara dhe bashkëpunimin me institucionet e tjera relevante në përmbushjen e obligimeve ligjore.

Kryetari – Pyeti për licencat që KPMM-ja është obliguar me Ligjin për miniera dhe minerale që t'i lëshojë: Sa ka kërkesa dhe interesim nga kompanitë për marrjen e këtyre licencave? Sa është inkasimi i gjobave nga gjykatat? Sa vendime janë marrë për dënimet që janë shqiptuar nga Inspektorati i Minierave të KPMM-së? Legjislacioni sekondar që është i paraparë edhe me Ligjin për miniera dhe minerale, a është nxjerrë nga KPMM-ja?

Teuta Sahatqija - Në raport nuk janë cekur se cilat janë arsyet e refuzimit për licenca për kompanitë që aplikojnë.

Pyeti: Pse është shpenzuar vetëm 10% e buxhetit që është i ndarë për këshilldhënie?

Visar Ymeri – Pyeti: Pse nuk ka informata të hollësishme në raport për mosdhënie të licencave dhe sipas Ligjit për miniera dhe minerale, a ka pengesa në këtë drejtim? Cilat janë udhëzimet administrative të cilat deri tani i ka nxjerrë KPMM-ja? Cili është bashkëpunimi ndërinstitutional

i KPMM-së me institucionet e tjera? Kërkoj sqarim më të detajuar për 12 licencat për hulumtim që janë dhënë kompanisë “Bechtel & Enka”.

Lutfi Zharku – Pyeti: Pse Inspektorati i Minierave të KPMM-së, në mënyre arbitrare me një vendim u ka pezulluar kompanive licencat dhe cila është baza ligjore për të marrë vendime të prera dhe a ka analizuar dhe marrë për bazë KPMM-ja vështirësitë që mund t’u paraqiten kompanive që kanë investuar shumë në makinerinë e punës?

Sala Berisha-Shala – Pyeti: Te Departamenti i Gjeologjisë, a e ka filluar KPMM-ja koordinimin me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik që t’i barten disa kompetenca në departamentet e MZHE-së? Çka ka ndërmarrë KPMM-ja që Departamenti i Gjeologjisë të jetë pjesë e Institutit të Gjeologjisë që duhet funksionojë si pavarur ?

Myzejene Selmani – Tha se ky Raport vjetor i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2011, është shumë përmbajtjesor dhe shumë mirë i hartuar, por kërkoj nga përfaqësuesi i KPMM-së që të angazhohet më shumë rreth parandalimit të operatorëve ilegalë të shfrytëzimit të zhavorrit. Pastaj ngriti disa çështje, siç janë: për strategjinë minerare që nuk është miratuar ende, për rentat minerare tha që kur të privatizohet ndërtimi i termocentralit “Kosova e Re” të ketë kujdes si duhet shfrytëzuar këto pasuri nga kompania që e fiton tenderin. Pyeti për kushtet e punëtorëve që punojnë në miniera se a apo zbatohet Ligji i punës për kushtet e punëtorëve.

Hashim Deshishku - Pyeti për pezullimin e 29 licencave që u janë bërë kompanive për mos-shfrytëzim të zhavorrit, çka do të ndodhë me këto investime që i kanë bërë kompanitë për blerjen mjeteve të punës. Te çështja e financave tha se pse kemi inkasim me vonesë, lidhur me gjobat për rentat minerare tha se pse ka kaq shumë kompani të dënuara dhe ku qëndron problemi, ndërsa për kallëzimet penale nga gjykatat që ju bëhen kompanive, kërkoj sqarime më të detajuara.

Ahmet Tmava (kryesues i Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale) - Ju përgjigj pyetjeve që ngritën anëtarët e Komisionit. Duke pasur parasysh se shumë shfrytëzues të rërës dhe zhavorrit, pa licencë kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme ambientale, në vazhden e ndërprerjes së veprimeve ilegale, me vendim të Qeverisë është bërë pezullimi i të gjitha licencave për shfrytëzim të rërës dhe zhavorrit. Me këtë vendim është fuqizuar veprimi për konfiskim të makinerisë së kompanive që kanë shfrytëzuar rërë dhe zhavorr në mënyrë ilegale. Deri më tani janë konfiskuar 6 kamionë dhe një ekskavator, raste këto që për KPMM-në kanë pasur implikime buxhetore. Në bashkëpunim edhe me institucionet tjera të Republikës së Kosovës, siç janë: MMPH-ja, komunat përkatëse dhe OJQ “Zhavorri” si partner në mbikëqyrjen e këtyre operuesve, u janë kthyer licencat e shfrytëzimit, të cilat janë konform Ligjit. Kemi intensifikim të inspektimeve në terren dhe nëse nga zyrtarët e KPMM-së ka pasur vërejtje, janë marrë masa ligjore në përputhje me nenin 9 të Ligjit për miniera dhe minerale, ndërsa këtyre kompanive iu është dërguar aktvendimi për mospërputhshmëri, iu është caktuar një afat për pezullim të aktivitetit derisa kompanitë i kanë përmirësuar vërejtjet, duke iu përmbajtur kushteve të licencës. Duke pasur parasysh pasojat e operuesve ilegalë, KPMM-ja ka bërë kallëzime penale për të gjithë operuesit ilegalë (mbi 90 kallëzime penale për vitin 2011) duke i dërguar ato në prokuroritë komunale kompetente. Kemi pasur disa takime me kryeprokurorin e shtetit, duke kërkuar përkrahje që këto lëndë të fitojnë prioritet për trajtim por edhe efekti i gjobave të jetë meritë, sepse sipas mendimit tonë ka pasur edhe shqiptim të gjobave në mënyrë joreale. Numri i lëndimeve dhe avarive në punë është më i vogël krahasuar me vitin paraprak, për shkak të aplikimit të sigurisë dhe masave që janë ndërmarrë në eliminimin e faktorëve të rrezikut dhe zbatimit të ligjit dhe Rregullores së sigurisë minerare. Në vitin 2011, fatmirësisht nuk ka pasur lëndime të të punësuarve me pasoja fatale. Në Inspektoratin e Minierave janë raportuar 9 lëndime të rënda dhe 2 lëndime kolektive. Më 25.03.2011 është publikuar në Gazetën Zyrtare të

Republikës së Kosovës, Udhëzimi Administrativ nr. 001/2011, për caktimin e kriterëve për personat përgjegjës në kompanitë të cilat janë të licencuar në KPMM, më 01.09.2011, është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Udhëzimi Administrativ nr. 002/2011, për menaxhimin e pasurisë së KPMM-së. Në mbledhjen e mbajtur me datën 13.07.2011, Bordi i KPMM-së aprovoi këto Udhëzime administrative: Udhëzimin Administrativ nr. 003/2011, për procedurat e sjelljes së garancive për përmbushjen e detyrimeve dhe sigurimin e rreziqeve për palët e treta- Udhëzimin administrativ nr. 004/2011 për rregullat dhe tarifat e shërbimeve për palët e treta të kryera nga Arkiva e KPMM-së, i cili është në procedurë për përkthim në gjuhët zyrtare. Udhëzimin Administrativ nr. 005/ 2011, për blerjen, ruajtjen dhe shpërndarjen e mallrave dhe Shërbimeve të kryera në KPMM- Udhëzimin Administrativ nr. 006/2011, për shpenzimet minimale të Hulumtimit. Udhëzimin Administrativ nr. 007/2011, për dënimet administrative dhe dënimet mandatore. Më 23.05.2011, Bordi i KPMM-së aprovoi Qarkoren, lidhur me punimin e lëndëve për operimet ilegale me nr. të protokollit 3094. Të gjitha kompanive iu është dërguar njoftimi për mospërputhshmëri, ashtu si parashihet në nenin 9 të Ligjit për miniera dhe minerale, iu është caktuar një afat për përmbushjen e kushteve nga licenca dhe nëse brenda afatit nuk i ka përmbushur kushtet e kërkuara, atëherë iu është pezulluar licenca. KPMM-ja e ushtron aktivitetin e vet duke u mbështetur në Ligjin për miniera dhe minerale. Kriteret në bazë të të cilave licencohen kompanitë janë të përcaktuara në nenin 23 për licencimin e kompanive për hulumtim dhe në nenin 33 janë të caktuara kriteret e licencimit të kompanive për shfrytëzim ku kërkohet që kompania të sjellë në KPMM pëlqimin nga komuna, nga MMPH dhe nëse është kultura mal, marrim pëlqimin edhe nga APK-ja. Duke marrë parasysh që KPMM-ja ka kuadër të përgatitur mirë profesionalisht, e kemi parë të arsyeshme të kursejmë buxhetin e Republikës së Kosovës. Sipas Ligjit për miniera dhe minerale, nuk është i kufizuar numri i licencave, por është e kufizuar sipërfaqja që një kompani mund të ketë dhe atë sipas nenit 21, paragrafi 4: Asnjë person në asnjë kohë nuk mund të mbajë licenca të shumëfishta për hulumtim të mineraleve ndërtimore që mbajnë në përgjithësi më shumë se 10 kilometra katrorë, kurse për mineralet tjera që mbulojnë në përgjithësi më shumë se 300 kilometra katrorë. Kompania “Niku S”- Gjakovë ka aplikuar në KPMM për t’u licencuar me licencë të shfrytëzimit të argjilës. Kjo kërkesë e kompanisë është shqyrtuar disa herë nga Bordi i KPMM-së, por për shkak të moskompletimit të dokumentacionit në bazë të Ligjit për miniera dhe minerale, nuk kemi pasur mundësi të licencimit. Kompania ka pranuar disa vërejtje nga KPMM-ja dhe i është sqaruar se çka duhet të komplotojë nga dokumentacioni, por nuk i ka plotësuar. Më 27.04.2012 anëtarët e Bordit të KPMM-së, së bashku me Komisionin nga Kuvendi i Kosovës- Komisionin për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor, kanë bërë vizitë te kjo kompani. Më 26.04.2012 Bordi i KPMM-së e ka shqyrtuar edhe një herë këtë kërkesë dhe kësaj kompanie i është dhënë afat 30 ditë për të kompletuar dokumentacionin, në të kundërtën do të veprohet sipas normave të Ligjit për miniera dhe minerale ku parashihet konfiskimi i makinerisë. Jemi treguar shumë azhur për dhënien e këtyre licencave, por meqenëse kemi këmbëngulur që kjo kompani t’i paguajë rentat minerale për buxhetin e Kosovës, atëherë kompania ka bërë kërkesë për mbyllje të licencave. Bordi i KPMM-së i ka aprovuar kërkesat për mbyllje dhe të gjitha licencat e kësaj kompanie janë mbyllur sipas Ligjit për miniera dhe minerale. Kemi bashkëpunim shumë të ngushtë me të gjitha institucionet. Kjo është treguar edhe me rastin e procesit të konfiskimit të makinerive të rasteve të operimeve ilegale si p.sh.: me MMPH-në, Policinë e Kosovës si dhe me komunat etj. Efekti i projektit të Plansheteve për përpilim të hartave gjeologjike në shkallë 1:25000, e bën vendin tonë me të dhëna në nivel më të lartë në shkallë studimore. Kjo ndikon në joshjen e drejtpërdrejtë të investitorëve, qoftë vendor apo të huaj për hulumtimin dhe shfrytëzimin e resurseve minerale. Për të gjitha kompanitë që kanë veprime ilegale, KPMM-ja i ka përcjellë vendimet për gjoba pranë gjykatave kompetente dhe tani procedura mbetet te gjykatat për ekzekutim. Kemi bashkëpunim shumë të mirë me Institutin e Gjeologjisë. Ne ju kemi ofruar të gjitha të dhënat e arkivit dhe laboratorin komplet. Bashkëpunojmë për përpilimin e rregulloreve si dhe marrim obligim ligjor sipas Memorandumit të bashkëpunimit në mes të KPMM-së dhe MZHE-së. Inspektorati i Minierave funksionon si departament në kuadër të

KPMM-së dhe ushtron funksionin e tij në pajtim me këtë Ligj, prandaj edhe raporti duhet të jetë si tërësi. Kemi edhe projekte, siç është Plani i menaxhimit të resurseve minerale (PMRM), i cili është një formë e valorizimit të informacioneve gjeologjike për hulumtime të mëtejme, por është i kushtëzuar nga aprovimi i Strategjisë minerare. Gjithashtu, një potencial me interes shumë të madh për vendin, siç janë zonat me interes të veçantë, nuk mund të valorizohen pa aprovimin e Strategjisë minerale. Ne kemi propozuar që renta minerare për thëngjill për projektin “Kosova e Re” të jetë 5% e vlerës së valorizuar të resursit, që sipas llogarive të bëra për momentin është 3euro. Ofrojmë të gjitha informacionet e hulumtimeve që posedojmë, hulumtimet e vjetra, hulumtimet gjeofizike, gjeokimike dhe tërë potencialin profesional. Këtë e kemi dëshmuar me ofrimin e shërbimeve profesionale për shumë kompani. Në bazë të Ligjit për miniera dhe minerale, duke u mbështetur në nenin 79, parashihet mënyra e përllëgaritjes së sasisë, të shfrytëzuar te operatorët ilegalë duke e trefishuar shumë e rentës minerale.

Pas debatit të gjerë, Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti vjetor i punës së Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2011.

Kuvendit ia paraqiti këtë

Rekomandim

Të miratohet Raporti vjetor i punës së Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2011.

4. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës

Kryetari- Tha se për Raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës, raportues i grupit të punës është z. Lutfi Zharku dhe ia dha fjalën për të paraqitur Raportin me rekomandime të grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimin e këtij Ligji.

Lutfi Zharku - Tha se grupi i punës ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës në bazë të planit të veprimit, të hartuar për monitorim, ku ka pasur disa takime dhe vizita nëpër terren dhe me ato institucione që kanë për ta zbatuar Ligjin në fjalë. Po ashtu, është organizuar dëgjimi publik me të gjitha palët e interesit dhe në fund është hartuar Raporti për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës me pesë (5) rekomandime, të cilat i prezantoi para Komisionit dhe i propozoi rekomandimet e grupit të punës: 1. Qeveria të përfshijë në plotësim dhe ndryshimin e Strategjisë Legjislative për vitin 2012, ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës; 2. Qeveria dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë të nxjerrë aktet nënligjore në afat prej tre (3) muajsh nga miratimi i këtyre rekomandimeve; 3. Autoriteti i Konkurrencës të Kosovës, në kuadër të kompetencave të tij, të nxjerrë aktet nënligjore në fushën e rregullimit të konkurrencës në afat prej tre (3) muajsh nga miratimi i këtyre rekomandimeve; 4. Autoriteti i Konkurrencës së Kosovës në përputhje me Statutin e miratuar nga Kuvendi, të nxjerrë aktet nënligjore për rregullimin e brendshëm të tij në afat prej tre (3) muajsh nga miratimi i këtyre rekomandimeve; 5. Autoriteti i Konkurrencës të Kosovës të përkrahet me veprime konkrete nga Kuvendi i Kosovës, në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe administrative.

Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr .03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës.

Kuvendit ia paraqiti këtë

Rekomandim

Të miratohet Raporti me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës.

5. Të ndryshme

Çështje vijuese.

Kryetari – I njoftoi deputetët për konferencën e GAP-it, lidhur me zbatimin e Ligjit për zonat ekonomike, më 18.05.2012. Gjithashtu, ai i njoftoi deputetët se në ditët e ardhshme do të organizohet një dëgjim publik për Strategjinë minerare, si dhe në fund, njoftoi për angazhimin e një eksperti nga NDI-ja, z. Flamur Hyseni.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit